



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, duke u bazuar në Vendimin e komisionit vlerësues për shpalljen e përfituesve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të (klubet sportive) Nr.5-453-16883 të datës 30.03.2022, Rekomandimit të komisionit vlerësues Nr.1-400/01-18822 të datës 12.04.2022, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR OJQ - TË (KLUBET SPORTIVE) PËR
VITIN 2022

Neni 1

1. Ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **110,000.00 €** (njëqind e dhjetmijë e euro), për t'i mbështetur financiarisht OJQ-të (klubet sportive) të Komunës së Lipjanit për zhvillimin e aktiviteteve të tyre për vitin 2022, të cilët kanë aplikuar sipas Thirrjes publike për aplikim Nr.1-400-7857 e datës 09.02.2022, ku gjithë procedura që nga shpallja publike e deri në nxerjen e këtij Vendimi është zhvilluar konform dispozitave të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

2. Në tabelën vijuese janë OJQ-të (klubet sportive) përfituese të cilat do të mbështeten financiarisht nga Komuna për vitin 2022:

Nr.	Emërtimi i OJQ-ve (klubet sportive)	Shuma
1.	KF "Ulpiana-1926" - Lipjan	40,000.00 €
2.	KF "Arbëria" - Dobrajë e Madhe	25,000.00 €
3.	KV "Ulpiana" femrat - Lipjan	4,000.00 €
4.	KF "Veteranët"	1,500.00 €
5.	KV "Skenderbeu"	5,000.00 €
6.	SHPSSH - Lipjan	1,500.00 €
7.	KV "Ulpiana" meshkujt - Lipjan	4,000.00 €
8.	KB "Ulpiana" - Lipjan	2,500.00 €
9.	KF "Minatori"	6,000.00 €
10.	SHF "Minatori"	1,500.00 €
11.	KV "Shpella e Mermerit"	2,500.00 €
12.	KF "Ulpiana-1992" - Lipjan	4,000.00 €

13.	KSH "Ulpiana"	1,500.00 €
14.	KA "Blinaja"	1,500.00 €
15.	KH "Ulpiana" meshkujt	1,500.00 €
16.	KGJ "Lipjani"	1,500.00 €
17.	KH "Ulpiana" femrat	2,500.00 €
18.	KSH "Ced Elita"	1,500.00 €
19.	KB "Lipjani"	2,500.00 €
	Shuma Totale	110,000.00 €

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria e subvencioneve të planifikuara për vitin 2022 të Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 3

Të drejtat dhe obligimet në mes të komunës dhe klubeve sportive do të rregullohen në Kontratat të cilat do të lidhen në mes të Kryetarit të Komunës dhe secilit klubë veq e veq.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

1Nr.400-18822

Lipjan, më 13.04.2022

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

